

Hapet thirrja për bursa në kuadër të Programin Erasmus + KA 2, për Projektin K-force për vitin akademik 2019-2020.

Universiteti i Tiranës hap thirrjen për aplikime për bursa për mobilitete në kuadër të programit Erasmus + KA2, për stafin akademik të UT-së, i cili merret me manaxhimin e projektit K- Force.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

-Shkëmbimin e stafit për mësimdhënie dhe trajnim, i cili merret me manaxhimin e projektit K-Force;

Universitetet në të cilat do të kryhet mobiliteti;

-Universiteti i Novi Sadit, Serbi – Mobilitet për Mësimdhënie (staf akademik);

- Universiteti i Novi Sadit, Serbi – Mobilitet për Trajnim (staf administrativ);

-Universiteti i Banja Lukës, Bosnje-Hercegovinë – Mobilitet për Trajnim (staf administrativ);

Kohëzgjatja e bursave:

-5 ditë + 2 ditë udhëtimi.

Dokumentat e nevojshme për aplikim për stafin:

- CV+ Lista e publikimeve (në gjuhën angleze) – vetëm për stafin akademik;

- Kopje e Pasaportës;

- Letër motivimi (në gjuhën angleze);

- Vërtetim Punësimi (në gjuhën shqipe);

- Certifikata e gjuhës së huaj B2 (Anglisht);

- Letër Suporti nga Koordinatorin e Projektit;

- Plani i mobilitetit për Trajnim (staf administrativ) ose Mësimdhënie (staf akademik);

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit për mësimdhënie klikoni në adresën:

http://www.unitir.edu.al/images/Mobility_Agreement_Teaching_outgoing.docx

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit për trajnim klikoni në adresën:

http://www.unitir.edu.al/images/Mobility_Agreement_Training_outgoing.docx

*Plani i Mobilitetit për stafin është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së mobilitetit. Ky dokument firmoset nga aplikanti dhe nga personi përgjegjës në Rektorat, i cili është Koordinatori Institucional i Erasmus +.

Afati për aplikim: 20 Janar 2020

Dokumentat duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtorja e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Studentët, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë nga e Hëna në të Enjte ora 10:30 – 11:30 dhe 14:30 – 16:00, si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin iro@unitir.edu.al.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në Sektorin për Marrëdhëniet me Jashtë në adresën: iro@unitir.edu.al

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!